

Me Laps dhe Bibël

2026




Veprat e tua janë
të mrekullueshme,
dhe unë e di shumë
mirë këtë gjë.

Bibla - Psalmet 139:14b

Janar

A nuk është natyra e
mrekullueshme? Perëndia tregon
përmes saj se Ai mund të bëjë
gjithçka dhe ka menduar për
gjithçka. Sa marrëzi është të
besosh se i gjithë krijimi u krijua
vetvetiu.

Perëndia krijoi arinjtë - po ashtu dhe ty dhe mua. Ti mund t'i
besosh Atij për të të ndihmuar dhe për t'u kujdesur për gjithçka
në jetën tënde. Ai të do!



1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

26

27

28

29


30

31

Shkurt

Oh jo, miushi është në rrezik! Duhet të fshihet shpejt,
ose macja do ta kapë.

A je fshehur ndonjëherë sepse ke bërë diçka të gabuar dhe ke pasur
frikë se mos zbulohesh? Perëndia po të thërret. Ndryshe nga macja,
Ai nuk dëshiron të të lëndojë, por të të falë. Kërkoji Atij falje me
singeritet dhe nuk do të kesh më nevojë të fshihesh.



Atëherë Zoti Perëndi thirri
njeriun dhe i tha: “Ku je?”

Lum ai të cilit
i kanë falur shkeljen,
ai të cilit i kanë
mbuluar mëkatin.

Bibla - Psalmet 32:1



Piktori mbulon vetëm njollat në mur me bojë të re. Por kur Perëndia fal, njollat e mëkatis zhduken vërtet. Njollat brenda teje shfaqen, për shembull, kur vjedh, gënjen ose i thua dikujt fjalë lënduese.

Nëse beson në Jezu Krishtin dhe ia rrëfen mëkatiset e tua, do të pastrohesh dhe nuk do të mbetet asnjë njollë e vetme.



- 1
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25
- 26
- 27
- 28
- 29
- 30
- 31

Kush ka veshë për të dëgjuar, le të dëgjojë!

Bibla - Mateu 11:15

Prill

Lepuri i madh po i thotë më të voglit diçka të rëndësishme. Është mirë që lepurit i vogël po dëgjon me kujdes. Perëndia dëshiron të të thotë edhe ty diçka, sepse Ai të do shumë. Ai të ka shkruar edhe një letër! Ajo letër është Bibla. Lexoje, ose bëj që dikë të ta lexojë, për të dëgjuar atë që Perëndia dëshiron të të tregojë për veten e Tij dhe për ty.



1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30

Perëndia është shumë i fortë.
Ai krijoi qiejt, tokën, të gjitha
kafshët dhe njerëzit gjithashtu.
Edhe pse ne nuk mund ta shohim
Atë, Ai është kudo dhe mbikëqyr
atë që Ai ka bërë. Ai të sheh edhe
ty. Ti mund t'i besosh Atij për
ndihmë me çdo problem që has.

Maj

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

26

27

28


29

30

31

Në fillim Perëndia
krijoi qiejt dhe tokën.

Bibla - Zanafilla 1:1



Trego kujdes për fjalët e mia.

Bibla - Fjalët e Urta 4:20a

Qershor



Bibla është Fjala e Perëndisë dhe të jep mbështetje për jetën tënde me Jezu Krishtin. Fjala e Perëndisë nuk ndryshon; është po aq e vërtetë sot sa ishte shumë e shumë vite më parë kur u shkrua. Perëndia ka një përgjigje për çdo pyetje.

Lexo Biblën dhe mbaji mend mirë fjalët e Perëndisë.

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25
- 26
- 27
- 28
- 29
- 30

Ejani, të kthehemi tek Zoti.

Bibla - Osea 6:1a

Korrik

Perëndia po na pret krahëhapur. Ai dëshiron që ne të vijmë tek Ai. Kjo është arsyeja pse Ai ka bërë gjithçka për ta bërë të mundur këtë. Biri i Tij, Jezu Krishti, mori ndëshkimin për mendimet dhe veprimet tona të gabuara kur vdiq në kryq. Nëpërmjet kësaj, Perëndia të fton sot të vish tek Ai. Pranoje ftesën e Tij!



1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30
31

Gusht

A ke debatuar
ndonjëherë,
ke gënjyer apo
ke treguar
mosbindje?
Ne të gjithë
i bëjmë këto
gjëra sepse jemi
si delet që ikin
nga Perëndia.
Perëndia duhet të
ndëshkojë atë që
është e gabuar,
por Biri i Tij, Jezu
Krishti, erdhi
në tokë dhe u
ndëshkua në kryq
për gabimet tona.

Nëse i lutesh
Atij, i rrëfen
me ndershmëri
gabimet e tua dhe
i beson Atij me
gjithë zemër,
Ai do të të falë
dhe do të të
udhëheqë në një
rrugë të mirë.



Ne të gjithë endeshim si dele; secili
prej nesh ndiqte rrugën e vet.


Shtator

Ti i ke sytë
tepër të pastër
për të parë
të keqen.


Bibla - Habakuku 1:13a

Ky varg flet
rreth Perëndisë.
Fatkeqësisht, ne
ndonjëherë bëjmë
gjëra të gabuara,
si gënjeshtër ose të
qenit të pabindur, sepse
zemrat tona nuk janë të
pastra. Kjo është arsyeja pse
ne jemi të ndarë nga Perëndia.
Por Perëndia na do shumë mua
dhe ty dhe dëshiron që të jemi
të pastër. Ne nuk mund ta
bëjmë vetë. Lexo faqen e fundit
të kalendarit - të tregon se si
Perëndia ndërtoi një urë që ne të
mund të vijmë tek Ai.

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25
- 26
- 27
- 28
- 29
- 30



Tetor



Shiko botën natyrore që ke përreth dhe veten. Perëndia i bëri të gjitha këto dhe e quan krijimin e Tij. Nuk u krijua vetë, sepse diçka kaq e bukur dhe që funksionon në mënyrë perfekte nuk mund të krijohej kurrë rastësisht, as pas një kohe të paimagjinueshme. Perëndia është i fuqishëm - shumë i fuqishëm, ndaj kije parasysh këtë!

Ndalu dhe
merr parasysh
mrekullitë
e Perëndisë!

Bibla - Jobi 37:14b



1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30
31

Po t'i rrëfejmë
mëkatet tona,
ai (Perëndia) është besnik dhe
i drejtë që të na falë mëkatet dhe
të na pastrojë nga çdo paudhësi.

Bibla - 1 e Gjonit 1:9

Nëntor




Kjo fjali nga Fjala e Perëndisë, Bibla,
është një premtim i bukur. Ne të gjithë
kemi menduar dhe kemi bërë shumë
gjëra që Perëndia i quan "të gabuara".
Por Perëndia ka premtuar se do të na
falë për gjithçka nëse e rrëfejmë atë.
Gjithmonë mund të vish përsëri tek Ai
dhe nuk mund të bësh kurrë aq shumë
keq sa Perëndia të mos të falë.

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30

Përgjigja
e ëmbël
e fashit
zemërimin,
por fjala
therëse
e nxit
zemërimin.

Bibla - Fjalët e Urta 15:1

Dhjetor




Një aksident mund të ndodhë kaq shpejt. Askush nuk donte të shkaktonte dëm, por tani ka një problem të madh. Si reagoni kur dikush ju lëndon pa dashje? A e fajëson personin tjetër dhe zemërohesh, apo përpiqesh ta kuptosh dhe ta falësh?

Ashtu si Jezusi dëshiron të të falë ty, edhe ti mund të falësh të tjerët.

1
2
3
4
5
6
7
8
9
10
11
12
13
14
15
16
17
18
19
20
21
22
23
24
25
26
27
28
29
30
31

I NDARË NGA PERËNDIA



Paudhësitë tuaja kanë shkaktuar
një ndarje midis jush dhe Perëndisë tuaj.
Bibla - Isaia 59:2

Zoti është i mirë - në Të nuk ka asgjë të keqe ose të ligë.
Nga ana tjetër, ne përdorim fjalë të këqija, jemi xhelozë,
të pabindur ose sillemi keq me njerëzit e tjerë.
Zoti e quan gjithë këtë mëkat.

Mëkati ka krijuar një ndarje nga Zoti. Mënyra se si jemi,
nuk përshtatet me Zotin. Mëkati është - ashtu si në figurë -
hendeku i thellë midis teje dhe Zotit.

Ne nuk arrijmë ta kapërcejmë vetë këtë "hendek të mëkatit".
Po tani? A ka ndonjë që mund ta kapërcejë këtë hendek?
A nuk ka urë midis nesh dhe Zotit? Po ka!

Vetë Zoti e ndërtoi këtë urë për ne sepse Zoti na do ne
njerëzit. Nga dashuria, Ai dërgoi Birin e Tij të vetëm
- Jezu Krishtin - të bëhej kjo urë për tek Zoti.



Perëndia e deshi aq botën,
sa dha Birin e tij të vetëmlindurin.
Bibla - Gjoni 3:16



Jezu Krishti thotë: Unë jam udha ...
Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje.
Bibla - Gjoni 14:6

Jezu Krishti u ndëshkua për të keqen që ke bërë ti. Kjo
është mënyra se si Ai u bë udha drejt Zotit. Sidoqoftë, ti
duhet të shkosh në këtë udhë për ta kapërcyer këtë hendek.

Si funksionon kjo? - Beso se Zoti Jezus ka vdekur për
mëkatet e tua në kryq. Tregoji Atij mëkatet e tua dhe
thua që të vjen keq për to. Kërkoji Zotit Jezus të t'i falë
mëkatet e tua. Atëherë Ai do të të shpëtojë dhe kështu

do të bëhet për ty udha mbi këtë urë për tek Zoti. Jezusi
po të pret dhe do të gëzohet shumë nëse vjen tek Ai.

Po t'i rrëfejmë mëkatet tona,
ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet
dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.
Bibla - 1 Gjonit 1:9

Sapo ta kesh bërë këtë dhe ta kesh kapërcyer urën,
Zoti do të të presë. Atëherë do të mund të flasësh me
Të në çdo kohë, ti do të shpëtohesh dhe gjithçka është
mirë midis Zotit dhe teje!



JETA ME PERËNDINË



GBV Dillenburg GmbH
 Eiershäuser Straße 54
 35713 Eschenburg
GERMANY
www.gbv-dillenburg.de
www.gbv-online.org
www.bibleo.org

**NUMËR KONTAKTI
 PËR SHQIPËRI**
 0674400217

© 2025 by GBV
 printed in Germany

Bibla, Lajmi i Mirë

ISBN 978-3-98824-272-3

GBV 814 7820 Crayon and Bible **Albanian**



© Grafik: iBuhl